

*Seferi S. Jaimosi
Klona 171*

VITI I VII.

— SHKURT 1936 —

Nr. 2

NORMALISTI

Jo në dijën, por në vullnetin
e fortë qëndron
vlëra e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshmeja "NORMALISTI,"
Shkolla Normale
Elbasan.

Antypshkronja "SAIDE," Elbasan
1936

DHURUAR
NGA

S. ZAIMASI

Normalisti

E përkohëshme pedagogjike, letrare, shkencore
DEL NË FUND TË ÇDO MUAJI.

E botojnë nxënësit e Normales.

Editor : Harilla Kuçuli '37.

Sekretar : Hysejn Hashorva '37.

Arkëtar : Jovan Gjeiga '37.

Ndihmësit

Polikron Niçe '38.

Panajot Foto '38.

Elami Nimani '39.

**Pajtimi : për gjashtë numra 1 Fr. ari
Nji numër kushton 1 Lekë.**

Dorëshkrimet nuk kthehen.

Lefti Primitas:

Reth punës s'onë

S'ka gjë të përsosur në Botë.

Me qenë se vet njerëzit paraqisin të meta prandaj dhe punët e tyre, të shumtën e herës, dalin jo të mbaruara. Ishte e natyrëshme, pra, q'edhe numëri i parë i së përkohëshmes s'onë të dilte me të meta.

Të metat t'ona në numrin e kaluar ndaheshin në dy: së pari qenë mungesat që na vetë i njihnim dhe nuk mund t'i përjashtonim dot. Të metat e tjera qenë ato që na nuk mund të vinim re dhe të cilat rithnin nga mungesa e përvojës s'onë. Të parat, duke i patur gjithëmonë ndërmënd, u munduam t'i shdukim që në këtë numër.

Dikush mund të pyesi: **po të metat e tjera nga i muart veshë?**— la se ç'ngjau: **Dashamirët e së përkohëshmes s'onë vrapuan përnjiherësh të na i pëshpëritin në vesh.**

Këta miq të "Normalistit", pasi pritën me gëzimin më të math dukjen e së përkohëshmes, na dërguan bashkë me fjalët e tyre të mira dhe këshilla për shdukjen e të metave. Me kënaqësi shinojmë se midis këtyre qenë dhe arsimtarë të dalun jo nga gjiri i kësaj shkollë. Kjo na gëzon tepër se provon që të gjithë e ndjejnë dobin e "Normalistit". Miqve të lart përmendur u dërgojmë falenderimet ma të nxehta për ndjenjat simpatike që vrapuan t'i çfaqin së përkohëshmes s'onë.

Na pëlqen të bëjmë të njohur botërisht, të gjith atyre që duan mbarëvajtjen e "Normalistit", këto: si të rinj që jemi, për mungese praktike ose "takt-i", mund të bëjmë në të arthmen edhe gabime të tjera në punën t'onë. Për hir të përmirësimit të së përkohëshmes s'onë presim prej kujdo me perulësi këshilla sinqerisht të dobishme. Ay që na do të "mirën", le të marrë mundimin, me letrë të veçantë, të na shkruajë, herë pas here, të metat ose përmirësimet që paraqesim. Kundrejt këtij shërbimi do t.i jemi mirënjohës.

Thjesht pedagogjike?

Një arsimtar i zoti, përkrahës i "Normalistit", si nga pik-pamja lëndore ashtu dhe nga ajo morale, në një letre të tij plot kuptim, midis të tjerave, na thotë: "Normalisti", pas mendimit t'im, duhet të të jetë organ i gjithë mësonjësve. Si i këtillë duhet

të përmbajë lëndë thjesht pedagogjike si në teori ashtu dhe në praktikë (prova).—

Mikut t'onë i japim plotsisht të drejtë. Mirpo kjo nuk mund të bëhet për dy arsye: së pari se një nga qëllimet e "Normalisti t., është të nxisi kandidatët mësuës (normalistet) të mendojnë dhe të shkruajnë. Si i këtillë duhet të çmojë shkrimet e tyre (novella, kallzime morali, vjersha). Arsyeja e dytë është edhe m'e fortë. "Normalisti,, ka një tok pajtimtarësh jo mësuës. Kujt i shkon ndërmend q'e përkohëshmjia e jonë ka pajtimtarë oficera dhe nënofficera ?

Kjo rjedh nga se disa nga mësuesit t'anë nuk pajtohen tek "Normalisti,,. Një pjesë e tyre nuk pajtohen se nuk kanë besimin Pjesa tjetër, duke mos patur vetëdijë të kthjellt të vlerës së tyre, i quajnë shkrimet që përmban "Normalisti,, pa rëndësi. Këtyre të fundit u kujtojmë: me n'anë se deri sa janë arsimtarë "duhet të jenë nxënës në kuptimin etimologjik të fjalës,,. M'anë tjetër i ftojme të na dërgojnë artikujt e tyre me vlerë(?)

Përfundimi: Që të bëhet plotsisht "Normalisti,, organ i gjithë mësuesve duhet edhe të mbahet prej tyre. Deri sa të jetë rob ekonomikisht i klasave të ndryshme të popullit nuk do të ketë një drejtun të caktuar dhe sikurse duhet.

Harilla Kuçuli '37.

"Bujku lavron tokën e mban jetën gjallë e mësuesi lavron e trajton shpirtin e zemrën e njeriut dhe heth themelet e forta të shtjellimit e të naltësimit shoqëruer,,.

(Shënim Kjo është tema e stazhit të sivjetëm. Sot po botojmë këtë themë ashtu siç e shvilloi një nga kandidatët, Jorgj Kavarati.)

Bujku është ai që punon e mundohet gjithë jetën, për të sigurue ushqimin e gjithë botës. Prej mëngjezit deri në mbramje shifet n'arë tue punue pa-pra vetëm e vetëm për me mbajtur gjallë njerzin. Jo vetëm ai, por edhe gjithë familja e tij përpiqen për atë punë të nalt, për atë punë plot vleftë, për atë punë, nga e cila varet jeta e njerëzvet. Që të kuptojmë rëndësin e madhe të bujkut, le të marrim me mend sikur ky s'është në

jetë: sikur të mos punohesh e të lavrohesh toka prej 'tij, do ti vinte botës një vdekje e përgjithëshme.

Mirë-po është një bujk tjetër, i cili nuk lavron tokën, por lavron e trajton shpirtin e zemrën e njeriut dhe vë themelet e shëndosha, mbi të cilat do të ndërtohet shoqëria njerzore! Ky është mësuesi!

Bujku mban jetën gjallë nga pikëpamja lëndore, kurse mësuesi e mbanë të gjallë nga një pikëpamje tjetër, nga një pikëpamje më të lartë, nga pikëpamja morale. Pa bujkun do t'i vinte botës një vdekje lëndore, por pa mësuesin do t'i vinte asaj një vdekje morale, e cila është shumë më e keqe se e para. Sikurse bujku punon e lavron tokën, ashtu edhe mësuesi e trajton gjërat më të çmueshme të njeriut, gjërat më fisnike, shpirtin e zemrën. Sikurse bujku pastron arën a kopshtin prej ferrave a prej ndonjë bime tjetër të dëmshme, ashtu edhe mësuesi pastron e harr prej shpirtit të njeriut veset e mbrapështa e çdo gjë tjetër të ligë, që pengon zhvillimin e shtjellimin e mirë të 'tij. Bujku kujdeset për bimët tue i njitun e tue i prashitun, por mësuesi kujdeset për njerzit tue i këshillue e tue u tregue udhën më të mirë, për t'ia mbërrijë të përsosmis më të mirë të tyne.

Shifet pra çiltas se puna e mësuesit është shumë më delikate, por edhe shumë më e rëndësishme se ajo e bujkut. Njeriu i vjen mësuesit si një brum i pagatuem; për gatimin e këtij brumi do të ketë kujdes të math e do të përdori gjithë mjeshtërinë e vet, kështu që të gahet mirë e pa të metë. Mësuesit i afrohet njeriu njeri vetëm me trup, por i largohet njeri edhe me shpirt. Mësuesi është ai që nxjerr nga dora e 'tij gjërat më të çmueshme, gjërat më të vlefshme e më fisnike, njerin. Prej dorës së mësuesit kanë dalë e po dalin mendjet e mëdha, që kanë ndriçue e po ndriçojnë botën me çpikjet e tyne. Sikurse zdrukthitari e zdruk e e bënë të drejt një dru të shtrëmbët, kështu edhe mësuesi e zdruk me zdrukthin e vet shpirtin e individit dhe e bënë të tillë, që të jetë i vlefshëm për vehten e vet dhe për shoqërinë e njerëzvet. Mësuesi është ai që i bënë njerzit të duen të drejtën, të vërtetën, moralin e shumë virtyte të t'jera. Mësuesi është ai që tue iu drejtue zemrës e shpirtit të njerëzvet i bënë fisnikë, i bënë që të marin pjesë në gëzimet e n'ldhnimet e të tjerëve, me një fjalë u kall ndjenja të nalta e fisnike. Përparimi, lulëzimi, qytetnimi erdhën nga mësuesi; atij do t'i jemi mirënjohës, atij, që

me trajtimin e me gatimin e mirë të shpirtit të njerëzvet, qiti në dritë njerës, qi suellën përparimin e qytetnimit.

Kuptohet pra se mësuesi është ai qi heth themelet e forta të shtjellimit dhe të naltësimit shoqner. Në qoftë se e marrim me mend shoqnin njerzore si një pëlhurë, mësuesi është ai qi ka dhënë kësaj pëlhure lëndën më të parë, fijet. Tue ndrequn ky e tue u kujdesun për çdo njeri, është kujdesun e ka ndrequn shoqnin njerzore; me naltësimin e shtjellimin e individit ka naltësue e ka shtjellue botën marë. Puna e 'tij i drejtohet shpirtit e zemrës së njeriut; me formimin e mirë të shpirtit e të zemrës, vjen vetvetiu formimi i mirë e i plotë dhe naltësimi i shoqnis njerzore. Punën e mësuesit e kanë çmue edhe të vjetrit. Brahma, profet i hindasvet të vjetër, i detyronte mësuesit një nderim më të math se prindit; mbas Atij, mësuesi ishte baba i shpirtit e prindi i trupit. Edhe shumë të tjerë e kanë kuptue e çmue punën e edukatorit, mbassi ky ka të bājë me shpirt e jo me gjana lëndore si mjështrit e tjerë.

Pra, në qoftë se bujku është ai qi mban jetën gjallë lëndësisht, mësuesi është ai qi end e trajton shpirtina e heth themele të forta për shtjellimin e naltësimin e shoqnis dhe mban jetën gjallë moralisht.

Elbasan, më 7 XI 35

Kuvarati Jorgj.

Mësonjësi përpara mbeturive të kohës

Mësonjës, në kuptimin më të thellë të fjalës, do të thotë njeri me vetëdijë të ndritur mbi nevojat e shoqëris së tij, për kohën që jeton dhe mbi rrugën e kapërximit të saj në plotësim të këtyre nevojave. Gjithë përpjekja e mësonjësve të vërtetë qëndron në të kthyer të brezit të ri drejt rrugës së paraparë shpëtimtare.

Nga ky përkufizim i mësonjësit dhe i përpjekjes së 'tij, duket se ay orvatet të bënj me shoqërin po atë gjë që bën' me

Kush ndihmon "Normalistin", nuk pasuron njeri por mer pjesë në ngrehjen e ndërtesës së madhe të shkollës Shqiptare.

anijën e tij një kapedan detarije, pse që të dy i kushtohen një qëllimi: ecjes më të mirë. Dyke e verejtur çështjen e veprës së tyre nga pikpamja e vështirësis, njeriu, mbas një gjykimi të përjashtëm, do të përfundonte se mësonjësi, i cili ka të bënj me kreatyra mendonjëse, e ka barrën më të lehtë nga kapedani; anijës, që i ka hesapet me valë deti të tërbuar që s' dijn' as një as dy.

Këtë përfundim do t' a pranonte cilido që është stërvitur t' arsyetojë objektivisht, por vetëm mbas dukjes së jashtme të gjërave, pse ay që e njuh mirë natyrën njerëzore do të ngulë këmbë për të përkundërtën. Në qoftë se sulmi i valëve t' egra, që s' dijnë as një as dy, është vështirë të përballohet, hovi i turmës mendojëse, kushtuar të shkonj mbas së vetës, është shumë më zor të drejtohet. Vështirësit e mësonjësit janë më të mëdha dhe veçanërisht ato të mësonjësit t' onë, me të cilin duam të merremi.



Thamë se mësonjësi i vërtetë është një njeri i kushtuar tërësisht të drejtonj shoqërin — posaçërisht pjesën në rritje e sipër — drejt kuptimit t' atyre të vërtetave mëndore dhe morale, të cilat do t' a ndihmojnë të bënj një jetë më të mirë, në çdo pikëpamje. Përvetësim i këtyre të vërtetave të reja, rrënjësisht trupëzuar nga KOHA, për shoqërin do të thotë marshim mbas ligjëve të SHPIRTIT përparojës të gjithmonshëm.

Çdo shoqëri qëndron e ngrehur si mbas disa të vërtetave, të cilat i ka gjetur dhe i ka mbajtur të drejta, për vitra me radhë. Këto të vërteta, si mbas ligjit të Natyrës, duhet t' ua lëshojnë vendin më të reja, mirëpo individët që i kanë pranuar të vërtetat e vjetra dhe që s' kanë dritë mëndore as të shohin bukurin e të reja dhe as të diktojnë vjetërsimin e atyreve që mbajnë, në çdo mënyrë përpiqen të qëndrojnë me ato që kanë. Ja këtu del vështirësia e madhe e punës së mësonjësit, i cili kërkon të drejtonj një shoqëri që jo vetëm nuk e ndien tërësisht nevojën e ndryshimit, por edhe e kundërshton.

Çdo të vërtetë të këtyllë, vjetëruar gjer në palcë, por të mbajtur edhe më këmbë nga ngurrimi i turmës, që nuk e kupton çvlerësimin e sajë, na do t' a quajmë një mbeturi të kohës së shkuar.

Shoqërit njerëzore kudo kanë nga një numër kësi mbeturish, që i sjellin pengim veprës së mësonjësit dhe hovit të përparimit përgjithësisht. Shoqëria e jonë, shoqëria e mësonjësit Shqiptar, është plot me të tilla mbeturit prapanike, me të tilla ferra të rritura lirisht prej kohësh dhe t' ushqyera me vreret e sundonjësve shekullorë dhe armiqve të jetës s' onë kombtare. Shoqëria e jonë rënkon nga mbeturit e kohës së shkuar, është e mbushur me bestypte dhe vuan tmerësisht nga vargonjt e fanatizmës së mbjellur me tërë kujdesjet e djallëzuara t' atyre që deshën t' a humbin për jetë emrin Shqiptar, t' atyre që u-munduan t' a shtrembërojnë në Turk e Kaur.

Në këto ferra gjëmbashe të fanatizmës duhet t' i fusi duart mësonjësi i ynë, që t' i përgjaken, por duhet t' i fusi me atë zjarr që dashuron Mëmër e tij, pse ato ferra mbeturije këtu shpojnë syt e shqiponjave të réja, therin zemrën e Shqipëris. Dyke respektuar çdo fé me vlerë të pa dyshuar, mësonjësit s' i mbetet veç të luftonj çdo të vërtetë të vjetëruar, çdo mbeturit të dëmshme dhe çdo fanatizëm të verbër,

Kur them se mësonjësi Shqiptar ka për detyrë të luftonj paprerësisht kundra mbeturive të së shkuarës dhe veçanërisht kundër fanatizmës, nuk duhet të kuptohet një luftë direkte, një kazëm e përnjëhershme që do të shkatërronte çdo themel. Këjo gjë do të jetë pika e mbërritjes, por n' asnjë mënyrë ajo e nisjes. Një gabim i tillë do të na vinte në kundravajtje të tmershme me rrethin dhe familjen dhe, veç dëmit, s' do të sillte farë dobije. Në këtë luftë duhet një takt i menduar, i zgjedhur dhe i shtruar, një sulm i pabujshëm. Dyke biseduar mbi këtë pikë, një koleg i djegur, më tha : „ Zot, si mund t' a lejonj unë nxënësin njëmbëdhjet vjeçar të mbanj Ramazan ? Si mund të pranonj unë një gjë kaq të dëmshme për shëndetin e tij ? Në një moshë kaq të ré dhe me punë shkollore, ay s' duhet të mbanj agjërime dhe unë s' mund t' a lejonj ! „

Kolegu kish plotësisht të drejtë, por nga ana tjetër harronte se ku do t' a shpinte punën ndërhyrja direkte ! Në të tilla raste duhet fituar zemra e djalit dhe e prindit me fjalë t' ardhura, me këshilla miqësore dhe me prova bindëse, për damin fizik që shkakton agjërimi, ose çdo tjetër gjë e tillë, tek nxënësi. Po të bëhet ky skjarim puna ka mbaruar me fitim, pse s' ka prind që mos të dojë të mirën e fëmijës së vet,

Shkollat t'ona, janë afetare, por liria dhe nderimi i besimit tek në është një gjë e siguruar me statut. Dyke qenë pjesëtarë të një shkolle afetare, mësonjësit e sotshëm rrin indiferent dhe larg çdo veprimi fetar që bëhet mbi nxënësin jashta shkollës, në një rreth ku për fat të keq, bashk me parimet kristalore e moralisht të larta të besimeve t'onë futen dhe ndryshkësi (sado pa qëllim) fanatizmi. Një qëndresë e tillë s'është për t'u pëlqyer prej mësonjësit, i cili duhet të dijë çdo gjë që ndodh në jetën e fëmijës që mëson. Prandaj mësonjësi i zgjuar duhet të vijë në përpjekje me edukonjësit fetar të nxënësit të vet, të cilët, kësi rasti, do banin mësimet e fës që lejohen, por jo predikimet e vërtetësive të vjetëruara, që ndrydhn ndërgegjejen e pjesës më të madhe të popullit t'onë.

Dyke përfunduar përsërisim se detyra e mësonjësit është t'i rrëfenj brezit të ri rrugën drejt ditëve më të lumtura. Pengimet e tij, pa përfilur të metat arsimore (mjete mësimi etj) janë mbeturit e kohës së shkuar, të cilat rëndojnë tmerësisht mbi shpirtin Shqiptar. Këto mbeturit mësonjësi duhet t'i luftonj mjeshtërisht e pa mëshirë, dyke mos u-kursyer të bënj çdo therori që e lyp çlirimi i të rinjve nga mbeturit e kohës dhe lartësimi i bashkimit kombtar, për të mirë e të mbarë të Shqipëris.

Beqir Çela

Çashtje pedagogjike.

Psitaqizmi e pedantërija nëpër shkollat t'ona.

Nji nga qëllimet e para të pedagogjis së rë është edhe formimi i gjykimit të lirë nxënësi.

Psitaqizmi e pedantërija janë si me thënë dy mënyra të të mësuemi, të cilat e bënë nxënësin skllav të gjykimevet të të tjetret e krejt të pazotin e vehtes.

Ka shumë asish, të cilët i nxënë lëndët e mësimet përmendsh, pa kuptue gjâ, e i thonë po n'atë mënyrë, ose pse detyrohen, ose pse ashtu janë mësue qysh në fillim. Kjo është nji **psitaqizëm**. (1) Mbasandaj disa mësues kërkojnë që nxënësit t'i lidhin

e t' i shfaqin idetë, ashtu si mendojnë ata vetë (mësuesit). Kështu nxânsi, dhe si të rritet, për të dhanë një mendim të drejtë, duhet me pasun në xhep, mësuesin për t' i frymë në vesh fjalët e tij. Në këtë rrugë na çon **pedanterija**. (2)

Psitaqizmin e pedanterin le t' i quejmë si dy të këqija të mëdhaja, të cilat shifen edhe sot nepër shkollat t' ona të mesme e fillore.

Pse të mos i lëmë nxânësit t' i formojnë e t' i lidhin gjykimet me fjalët e veta, mjaft që të shfaqen vetë e pa të meta? Nuk flas për rregullat e mendimet, të cilët nuk mund të shfaqen ndryshe. Por është një marrëzi, kur e detyrojmë nxânësin të flasë për pulën ose kalin si ç' e ka fletori ase libri. Sa shembulla ka si këto!

Në qoftë se veprojmë kështu, atëhere le t' a dijme se bájme krime të pafalun, mbassi **robnojmë mendjet e lira të nxânësve**. Kur të rriten, ata nuk janë të zotët për me dhënë as mâ të voglin gjykim edhe për gjânat mâ të thjeshta. Gjithnji do të mendojnë e do të flasin si libër ase do të mbajnë mend ndonji frazë të kalbët të mësuesit. Mjer ata nxânës, kur të bâhen burra e turp për mësuesit se si i kanë rritun!

Po duem të rrisim njerës, që të mjaftohen me vehten e vet. Po duem të rrisim njerës me mendime të kulluet e të lirë e **jo parazitë!** Këtë thotë edukata. Këtë kërkon edhe shoqnija njerzore e atdheu. Kurse sot (veç shkollavet fillore) edhe nëpër shkollat e mesme shumë nxânës nuk mund të përmbledhin kuptimin e njëj copës së këndimit, të njëj vjerrshe ase të ndonjij mësimi t' jetër. Kjo vjen se ata kanë mësue maqinisht e pa farë kuptimi. Nëpër shkollat e mesme kjo e keqe ngjan edhe nga mungesa e tekstevet dhe e libravet të çdo lânde mësimi, në të cilën nxânësit nuk kanë ç' të zgjanohen. Prandaj detyrohen të kopjojnë në trût e 'tyne ato pak fjalë, për të cilat do të skuqeshin, kur të mendojshin se janë shumë pak. Por nga një herë

Do të mësoje mirë të tjerët vetëm ai që ka patur kujdes më përpara të mësojë vet-vehten.

Quintiliani

nuk kanë as faj, mbassi dhe mësuesi nuk u kërkon më tepër se ç'ka shkruet për ndonji subjekt se ndoshta s' din më gjatë... e mund t' i thotë nxënsit: " ku i gjete këto pallavra? „.

Sido qoftë psitaqizimi e pedanterija nuk lypset të durohen kurrë as ndër mësues, as ndër nxënës.

Dëshiron të bisedojsh me një të math, por s' ke se qysh. Nuk mund të shfaqish një idé. Nuk din të gjëjsh pënin e njëj bisede. Flet për uthëll e kapërxeen ke qumështi. Të gjithë kemi nga një lamsh mendimesh të ngatërruem fund e majë e besa zor se i gjindet kryet e fijos. Flasim, por nuk dijmë. Marrim të shkruejmë, por kopjojmë të gjithë.

Këto janë plagët e të metat e edukatës së parë. Nashti ndryshoi rrugë qerrja e arsimit (ose duhet të ndryshojë). Lypset të kujdesemi për gjykimin e të vegjëlvët, të cilët do të rriten. Le të na vijë turp, kur jemi burra e flasim si fëmij!

Edukatori i zoti le t' a ketë si rregullë të naltë këtë: **do të rris njerës me gjykim të lirë e të pavarun.** E lypset të jetë më se i sigurtë se atëhere e ka mbarue pjesën më të madhe të rritjes.

Më mirë le të kënaqemi me një gjykim gjysëm të drejtë të nxënsit (por t' a përmirësojmë), se sa t' i fusim me pahirë një gjykim të drejtë por të gatishëm. Nxënësi le të mësohet me gjykue dhe vetë. Mirpo na harrojmë gjithnjë. Duem që ai të dijë aqë sa ne e po n'atë rrjeshtim. Sa gabojmë e sa të marrë bähemi. Përpara se të jenë, i bëjmë fëmit burra. Kështu e thajmë e e pijmë atë trù të njomë.

Në qoftë se i vogli nuk ka fuqi të gjykojë, të paktën ka zotësi. Nxënsi mendon dhe gjykon vetë, edukatori e fuqizon e përçon në rrugë të drejtë mendjen e 'tij. Kuptimi i mësimit, të gjetunit e idës kryesore, përshkrimet e kallzimet e nxënësve, etj. e zhvillojnë shumë gjykimin e nxënësit. Mjafton t' a bëjsh të kuptueshëm mësimin, se ai nxihet vetë. Mos me lypun tepër përmendsh. Gjykime të gatishme fort rrallë.

E mira e jonë pra e lyp që psitaqizimi e pedantërija të shporren një herë e mirë nga shkollat t' ona, prej të cilavet më të shumtit e nxënësve dalin si maqina të ngrime e të ndryshkuna.

1 Psitaqizëm. Gr psitakos=papagall.

2. Pedanterija, fr pedant = ai që kërkon prej tjetrit një gjykim të formuem sikur e mendon vetë.

KÛR perdoret abetari në klasën e parë.

Sa e naltë, fisnike dhe shëjte, është detyra e mësuesit të klasës së parë, kur nder ditët e para të vjetit shkolluer, i paraqitet fëmija i vogël, i pazhvilluem (ndë, për me marrë prej si edukatë morale, mendore e fizike!

Por përpara kësajë vepre të naltë, arsimtari sidomos i riu gjindet përball disa vishtirsinave qi lypin kujdes e takt. Nji nder vishtirsina të kësaj klase është koha e përdorimit t'abetarit.

Sa arsimtarvet të klasës së parë u pëlqen të përdorunin e abetarit në fillim të vjetit shkolluer, atëhere kûr të jet zhvillue germa e parë, të knaqun si i knaqun kje Arkimedi, kur, tue dalë prej ujit gërthiti: Eureka¹⁾.

Psykologjija na mëson se fëmija xën shpejt për mendësh. Të përdorunin e abetarit në fillim të vjetit i ndihmon mekanizmes; pse fëmija mbassi t'a këtë ndi copën e këndimit për disa herë, prej mësuesit e prej shokësh i mban në mend mirë fjalët dhe është i zotë me i këndue mandej pa dijtë se ku janë. Për shembull fëmijit thonë fjalët e rreshtit të dytë në sa gishtin e kan të vuem në rreshtin e tretë o më përtej Këjo ndollë edhe nder të mdhaj. As të mdhajt nuk munden me i rá nji cope sado të lehtë muzike kûr të jen njoftë vetëm dy o tri notat e para²⁾.

Teksti i fëmis nder tre muejt e parë do të jet drrasa e zesë. Në të fëmija shkruen lirisht dhe e shlyen. Ndreqë e zbukuron shkrimin e germës tue bā njiherit edhe nji farë krahasimit me germat e tjera. I drejtuem prej mësuesit, me kohë fillon të formojë fjalë e fjali të thjeshta me doemos mbi gjanat e pame, të vrejuna e të nxanuna. Këjo mëndyrë ka edhe nji përfitim pse qysh tesh fëmija e ndin, vedin kondend me folë, me thanë diçka edhe aj e me bashkëpunue me shokë te drrasa e zezë.

Në fillim shkrimi s do të jet nji kopjim germash e fjalësh të thata, por nli diktat qi fëmija të mësohet me dijtë shka shkruen e me mendue para se të shkruen.

Vetun atëhere kûr nxansi të ket njoftë nji sasi germash e të ket bashkëpunue me to, çilet abetari. Abetari do të jetë nji hap i dytë fitimi e përparimi, do të jet pika e mbrijtjes e jo ajo e nisjes³⁾.

1) E gjeta. Verb grekisht prej Eurisko

2) Giuseppe Lombardo Radico: Lenzioni di didattico,

1) G. L. Radice.

Qëllimi i abetarit s'do të jët mundimi i nxansit i cilli mbas-
si t' a kët lagë prej lotësh e të rrahunash në familje, të nxân
çë prej kësajë kohe me e mnijë librin e shkollën, por do të jet
nji ushtrim ndoshta edhe jo aq i lehtë, por sigurisht i mujtshem
i sa punimeve qi ka krye përpara.

Mbassi të jët fitue vishtrisa e parë për përdorimin e abe-
tarit, vijimi dalë kadalë e me pak vullndet thehet së vedit.

E në fund të vjetit shkolluer tue pá se nxansit dijnë me
shkrue e me këndue **ad litteram**, dijnë me u përgjegjë pvetjeve
drejtë e pa ju trembë syni, mësuesi së vedit e ndin vedin të gzu-
eshëm, hartist i madh për veprën e naltë qi ka krye, tue thanë:

"Këtu kje krijue gjithkëta."

Shkodrë 15-11-36.

Tomë Gjyshji.

Detyra e lartë e mësuesit¹⁾

Dhurata më e madhe që një mësues mund t'i pregatit një
nxënësi, nuk është mësimi, por frymëzimi që mund t'i japi shpi-
ritit të 'tij.

Një grek i vjetër thotë: "Edukoe djalin t'ënd me një skllav,
e në vënd të njerit, do të kesh dy". Është e sigurtë se çdo i rri-
tur në qoftë se mendon jetën e 'tij shkollore do të ndallojë se
ajo që i ka ndihmuar më tepër ka qënë dëshira për studime
lindur nga një mësues me shpirt të lartë. Presidenti Charles F.
Twing një herë bëri një studim mbi përgjigjet e dhëna nga pesë-
dhjet persona rreth pyetjes: "Ç farë të mire u ka dhënë shkolla?,"
Pothuaj të gjithë u-përgjegjën se çdo e mirë rrjeth vetëm nga
marrëdhënja me njerës të mbédhej, një pakicë deklaruan për
arësimin. Në mes të përgjigjeve më të mira shënojmë atë të
presidentit Jordan: "Shkolla afron nxënësin te njerzit me vlerë,
përndryshe as nuk do t'i njihje dhe as nuk do t'u çmonte vlerën
e 'tyre". Dr. Parkhurst i shënon: "Ndërsa librat mësojnë, vetëm
një mësues shpirt-madh mund t'edukojë". Presidenti Twing mblo,
dhi këto përgjigje, e vërejti se çdo e mirë që u jpite shoilla
nxënësve ishte vepra frymëzuese e prodhuëse e së mirës s'edu-
katorit.

1) Njxjerrë nga "Shkolla Ideale," e Reston V. Searsh pedagog Amerikan,

Këjo nuk është e vërtetë vetëm për shkollat e larta, por akoma më tepër për t'ultat, sepse ne nuk do t'a çmojmë kurrë të mirën që mund të sjellë marrëdhënja me njerës shpirt-lartë në vitret e para të jetës.

Mësuësi duhet të zotërojë shëndet të mirë, mëndje të fuqishme, shpirt të pajisur me virtute të shumta. Që të ketë mëndjen gati e të zgjuar n'orët e mësimi, është e nevojshme që të mos vijë në shkollë i lodhur nga pregatitja e mësimëve e të mos humbasi kohën duke u përsëritur nxënësve ushtrime monotone e të mërzitshme. Ay duhet të kursejë energjinë e freskësin 'e mëndjes së 'tij për të ngjallur në shkollën e'tij dashurinë e entuziasmin për punë për të punuar me atë, e me atë t'i shijojë imtësisht e thellëlisht rezultatet që ajo përmban.

Përkthim nga italishtja

Vizi (V. D. V. '38)

Provë mësimi

Dhânë në rendin e III të t' Ushtrimores për Stazh.

Lânda : Mësim jete.

Thema : Dhoma e klasës dhe plani i 'saj në svoglim.

Mjeti : Metri, kartonat dhe kutija e rânës.

Procedimi : Analytik e synthetik.

Kandidati Selim Alliu.

Z h v i l l i m .

Mbassi vihet klasa në qetsi, verehen nx. për pastërti e mandej nis mësimi kështu :

Pyeten nxânësit të kallzojnë se ku ndodhemi tashti e si të dali fjala ke dhoma e klasës s' onë, atëhere mësuësi bisedon me fëmijët për anët e klasës e për orendit e 'saj. (ushtrime për anët e ndryshme). Si të përfliten këto pyeten nx. të gjejnë me mënd se sa e gjatë a e gjânë është klasa; tue qenë se ata s' mund t' a dijnë me mënd, atëhere u kujtojnë metrin. Kështu ndashki fillohet të matunit e gjatësis e gjânësis së dhomës, mandej dhe t' orendive. Masat shënohen prej mës. me radhë në skaj të dërrasës zezë, ndersa matjen e kryejnë nx. Si të jetë mbarue

këjo punë atëhere mës. u thotë atyneve se na duem të bëjmë një klasë si këjo. Bisedohet me nx. se ku mund t' a bëjmë më mirë e, si të dali puna ke kutija e rânës, përfillet me ata për madhësin e dhomës së klasës, qi duem të bëjmë. Këtu hynë puna e të dhënit kuptim për masën, qi do të përdorim, (1 me 20). Për me kuptue nx se si e svoglojmë madhësin e klasës, atëhere mës. i përçon të mendojnë e të provojnë se kur kemi këtu një vënd të gjatë 20 cm. (matet), për me e vizue 20 herë më të vogël, duhet t' a marrim 1 cm.; kështu vjen puna qi të kuptojnë radhazi se për 100 cm., të cilat bëjnë një metër, do të marrim 5 cm., etj. Si të jetë fitue këjo gjinden masat e svogëlueme të dhomës dhe t' orendive. Këto do të shënohen pranë masave të vërlleta në dërrasë të zezë për të pasë nx. një krahasim të të dy masave. Mbasandaj nxirren ata rreth kutisë së rânës, e, mbassi të tregohen ânët e dhomës e orendit e klasës prej kartoni të svogëlueme, nx. masin disa prej tyne. Mbas këtyne fillon ndërtimi prej nx. tue u shtymë prej mës. Si të mbarohet ndërtimi ushtrohen fëmijët në plan tue gjetë vendin e 'tyne, ânët e ndryshme dhe vendet e shokëve për rreth. Mbasandaj zëmë e i hekim me radhë kartonat, e kështu na mbeten vetëm vijat e lánuna prej 'tyne. Edhe në këtë rrasë bëhen shumë nga ushtrimet e përparëshme.

Nashti plani i dhomës i mbetun në rânët nga vijat e kartonevet, përhidhet në dërrasë të zezë prej mës., i cilli përfillet bashkë me nx. Në këtë kohë fëmijët nxiten të marrin me mend e të krahasojnë kutin e rânës të ngritun në këmbë, porsì dërrasa e zezë; doemos vijat e sipërme të kutisë së rânës do të vizohen n' ânë të sipërme të dërrasës së zezë; kështu vizohet i gjithë plani. Edhe këtu bëhen ushtrime si përpara. Si përmbledhje mësuesi u paraqet nx. një plan të klasës të vizatuem në një karton.

“ Normalisti „ e vetmja e përkohëshme që del në vendin t' onë për të rrahur çeshtje pedagogjike ka të drejtë të përkrahet nga të gjithë arsimtarët.

Provë mësimi

Dhânë ne rendin e III të t' Ushtrimores.

Lânda : Mësim jete.

Thema : Jeta e katundarit e ndryshimet e 'saj.

Z h v i l l i m .

Si të verehen nx. për pastërti, nis mës. punën e vet në këtë mënyrë :

Mësuesi u thotë nx. se sot, kur po shkoje nëpër pazar, pashë një burrë me jakuce, me shallvâr e me një qeleshe të bardhë. Pyeten se prej nga do të ketë qenë ky; kështu vjen fjala te katundari. Si të përgjigjen nx. se ai rron në katund, përflitet sipër e shkurt për ndryshimin në mes të katundit e të qytetit nga pikëpamja e madhësis e mandej del puna ke jetesa, përshkruhet me nx. banesa e katundarit, rrojtja, veshja e punët e 'tij. Kështu, tue fillue prej stinës së vjeshtës, në të cilën gjindemi, shkojmë me radhë dhe ndër stina të tjera Përmenden pra të vjelunit e pëmëvet, të mbledhunit e misrit, mbjellja e të lashtave, e përgatitja e ushqimit të kafshëvet, sidomos ndër malsina, ku në këtë kohë vehen mullâr me dushk. Veç këtyne zihen me gojë dhe të korrunit e orizit e të shkundunit e ullinit. Tregohet se nashti, mbassi nepër malsina afrohet të ftoftit, blegtorët zbresin nepër fusha me tufat e bagëtive. Mbasandaj përmenden vështrësit e jetës katundare në dimën, por edhe dëfrimet e katundarëve në këtë kohë. Nga dimni hudhemi në prandverë, zâmë me gojë punët e shumta të katundarëve; përshkruhet bukurija e katundit në prandverë.

Po kështu do të flitet dhe për verën; sidomos për të korrunit e barit dhe të të lashtave.

Si mbas rasës disa fjalë a fjali do të përfliten horas. Mâ në fund bâhet dhe një përmbledhje e mësimit dhe pyeten nx. të kallzojnë shkurt për jetën e katundarit.

Një kënaqësi puna e një ngushëllim detyra

Puna është një nevojë e domosdoshime, është një ligj i qenëjes s' onë një princip i gjallë që shtyn përpara njers e kombe.

Ne duhet të punojmë që të përmbushim idealet t'ona që zotërojnë fatet t'anë dhe që dalin në shesh me dëshirë të nxehtë për lumtëri. Jeta ka nevojë për vepërim e jetesa matet me intesitetin e nevojës së vepërimit. Njeriu energjik është një burim aktiviteti, kur ai ka mësuar se trupi është shërbetori i dëshirës dhe i nevojës së vehtes së tij; arësye themelore dhe e pa mohueshme e kënaqësisë, pse librimi i fuqive t'ona të brëndeshme është vetë gëzimi dhe kënaqësija. Ky librim i fuqive t'ona për punë, sa më shumë impresione të gjalla të na parashtrorjë, përpara organevet t'ona dhe sa më shumë të jetë i çliruar prej hallkave që lidhin e paralizojnë blerimin e plotë të shpirttrave t'onë, aqë më shumë i afrohet kënaqësisë e lumtërisë që fle ose përpëlitet në thellësitrat e ndërgjegjes.

Por ka njerës "përtacë", që kënaqen me një punë mekanike, pa mundime, dhe nuk dëshirojnë të ngjiten përmbi mundime, për shtëpi, e për të fituar bukën e përditëshme me djersën e ballit. Të tillë njerës kanë një jetë të errët, të pa njohur, e cila i heq zvarr dhe i vë në gjumë përfundërisht duke ubrehur zëmëren sikurse skurrja hekurin. Ne duhet të rrojmë duke punuar pse jeta e jonë nuk është e gjatë dhe e kënaqëshme nga vjetet e tepërm që ne kalojmë, por nga matja relative e asaj që kemi bërë a kemi provuar të bëjmë në udhëtimin e kësaj.

Ky udhëtim nuk është gjë t'jetër veç se koha në të cilën ne kalojmë; kapital i çmuar për të gjithë e shumë më i çmuar për ne të rinjtë, se me përdorimin e mirë të kësaj, vetëm ne munt t'i shijojmë frutat, kur në rrethin e mundimevet e të projektevet nuk pakësojmë guximin, frymën e lirë dhe entuziazmin, që janë krejt të domosdoshme si shtytësa në punë për të na siguar kënaqësinë t'onë e të mirën a përgjithëme.

Ne si nxënës çdo gjë na duket e rëndë dhe e lodhëshme, por asnjë nuk munt të pasurojë mëndjen pa lodhje, se dhe çdo gjë që duket e madhe tek njeriu është fituar me lodhje: "Ajo është vepra e punës, dhe qytetërimi është fryti i saj". Ne nuk munt të jemi kurrë të mirë e të virtutshëm në qoftë se nuk jemi të kënaqur, e kjo kënaqësi vjen vetëm nga punë, e cila shvillon zemrën, shpirtin e dorën.

Njeriu duke punuar çan levoshgën që e mbulon e përgjigjet gjithënjë: këtu si një ushtar besnik në krye t'asaj që përfaqon gjithë eksistencën njerzore: në krye të detyrës.

Sot për sot detyra e domosdoshme që ne i kemi ngarkuar vehtes është "studimi", i cili do të jetë një edukator i shpirtit e formimi i një okupacioni t'ëmbël e bujar, që një ditë të jetë ndihmuesi i ynë e i të t'jerëvet.

Por përsa na përket ne si Normalistë, nuk mjafton vetëm me rjeshtat e librave, por pak edhe me jetën e jashtme sidomos me atë te popullit t'onë. Pse lufta e sotme e jetës s'onë shoqërore na ngarkon, ne që jemi kandidatë për kurorën e mësuesis, detyra më delikate e më të shëjta. Dhe do të qemë të dënuar si kur të mbeteshim vetëm me shvillimin t'onë në pikëpamje didaktive e methodike, pa përfshirë nga rrënja pikat themelore të detyrës s'onë shoqërore. Pra kur ne të kemi mbledhë jo vetëm lulet që ndodhen brenda rrethit të shkollës por dhe ato jashtë tij, do të jemi në krye të detyrës dhe ajo do të na ngushëllojë për të arthmen. Pse vetëm në këtë mynyrë do të shtrydhim energjinë dhe kujdesin t'onë jo vetëm brënda mureve të ngushta të shkollës, që do të na ipet nesër në dorë, por edhe në të munduarit për të berë vetë popullin që të ketë një interes për shkollën e tij.

Pra vetëm me punë (e cila do të na kënaqi) do të plotësojmë detyrën si nxënës dhe në të nesërmen do të jemi në krye të detyrës, duke formuar një ushtëri ideale mësuesish për të rregulluar më mirë gurin e themelit t'edukatës s'onë kombëtare dhe për të qenë të vlefshim si për Shtet ashtu edhe për komb! Ajo që do të na kënaqi është vet puna; dhe ajo që do të na ngushëllojë detyra kur ne e plotësojmë me ndërgjegje!

P. Niçe (V. D. V. '38).

Ndërmjet nxanësve t'onë.

Nji djal fatkeq.

Më vjen në shkollë me nji palë rrobe të grisura, që të apin mëshirë. E këpucët? Shumë keq vetëm maja e këmbës qëndron mbrenda, pjesa tjetër është jashtë. Nji fëtyrë të prishun, duket sikur ka turp kur të shef. Asht nji nga ata fëmijë, që vuejnë shumë dhe vuejtja e tepërme e ka bëmë po thue se sikur nuk gëzon as ndonji të drejtë. Asht prej nji familje të vobegët barishte shitësish, të cilët me gjithë që kanë punuem dhe punojnë shumë, prap se prap kanë mbetun të vobegët, krejt të

lanun, të përbuzun prej shoqnisë njerzore. Njerëz të vobegë pra, që rrojnë në mizorinë më të madhe Ky fëmi është fruti, rezultati i asaj brezniye fatkeqe. Dhe banesa e tyre është një hanë, një dhomë e tymosun dhe e pasun me rrjeta mirimangash. Në kësi vende shtjellohet ai fëmi fatkeq.

Jo vetëm në të pamë, por edhe në punët shkollore duket shpirti i tij: një ditë shkruen mirë, ditë të tjera dhe n'orë të ndry, shme, keq. Edhe në vet vehte nuk është i qëndrueshëm, është gjithmonë tristueshëm. Dhe në qoftë se ndonji herë qesh, qesh vetëm së jashtmi, e qeshuna e tij përnji herësh kthehet në melankoni. Ai nuk është i zoti për një të qeshun e gëzim të vërtetë. Asht si një lule, që hap në stinën e dimnit. Natyra e tij është e shqetsueme dhe karakteri, melankolik.

Në qoftë se ai djali në shkollë gjenë ndopak gëzim e dashuni ndërmjet shokësh, ç'vlerë ka ajo për të, kurse në shtëpi, ku ai kalon kohën më të madhe, mbretton fatkeqsija?

Mbas disa kohësh pashë edhe nanën e tij. Fëtyra e saj ishte e verdhë, sytë të futun përbrenda dhe të korrokatun, mollzat e faqeve të daluna dhe lëkura e fytyrës 'saj bashkohesh me eshtnat.

Nga trupi ishte e deformeume dhe e plakun para kohe, ecte me hapa të ngandalshme, ishte krejt e paqetë, dukesh se vuante.

E ç'gëzim e dashuni mundet t'i apë ajo nanë djalit të sajë?

Në çdo punë që bëjmë në shkollë, ai është i mundueshëm. Edhe në oborr ai rri gjithnji i veçuem prej shokësh, nuk përzihet dhe nuk merr pjesë në lojna, me gjithë përpyekjet e mija.

Duket haptazi e ardhmja e këtij djali. . .

Ti o mësuës, sigurisht në shkollë tande do të keshë të këti-llë nshanës fatkëqij. Dashunija, që atij djali i mungon në shtëpi, duhet t'i epet në shkollë prej teje.

Gavril Santo '33.

E arthmja shoqërore dhe politike e njëj populli është problem' i edukatës.

Mazzini

Kur veriu tallet.....

Kjo është jetë Malet e hjedhta, kodrinat e ulta e fushoret e hapta gjindën nën shtrojën e bardhë të borës Sa bukuri është të kundrosh flokat e borës kah bijnë tue ndjekë njëna tjetren! S ka lumni e knaqsi më të madhe se të gjindesh nën një atmosferë të hapun, e nën qiella të vranta të zhvillosh, me grupin e shokve e të shoqeve, më të hijshmet lojna argtuese te stinës N'at kuadër të mrekullueshëm, syu nuk të shef tjetër veç harë të papërshkrueshme: mbi livadhe të priruna në teposhtë, të rrijt rrëshqasin me ski e saja më tej, një grup vajzash e djemësh rrahen me topa bore Të gjithë janë të gazmuem.. Bukurija e lugjeve bardhullore, ajo kunorë malesh thepat e të cilave shndritshin si xhevahire në parzmin e një mbretneshe, u lëmonte fantazin atyne të rijve që shijojshin ket pamje të hollë kristalore të natyrës

Sá i bukur është dimni kur gëzon një jetë të këtitël! Një jetë plot shëndet. . . .

Por . . . jo vetëm nën atmosferën e hapët lumnohet kaq me andje. . . . Edhe mbrenda mureve t'odës zhvillohet një jetë vertë e kandshme Por. . . . Ma pak e shëndetshme se ajo e para .. Oda: stufa mërdhezë prej së nxehtit lëshon ashtin e vet në të tanë odën Ose një grumbull zjarmi mbi një tangár lëshon nxehtësi dhe dritë ari Ose në ndo'i odë tjetër, në votër, ku drutë ndizen tue kërsitë dhe tue lëshue shkulma flaket të cilat tue forfuritë futen në grykë t'oxhakut. . . . Rreth votrës, rreth këtij vëndi të shëjt, zhvillohen bisedat më të zgjedhunat. Ktu shqiptari i ri trajtohet me ndjenja shqiptare Këtu shqiptari i vogël mëson historin e Skendër-beut E se Atdheu i tij është Shqipnija e se për Besë, Nderë e Burrni, për kto karakteristika të paçmueshme të shqiptarit, duhet me dhanë jetë A ka më mirë se rreth votrës, rreth zjarrmit të ligjrosh e të dëfrehesh ndër nett e gjata e plot suhi të dimnit? Më duket se s'ka Pra Edhe mbrenda një horizonti të caktuem zhvillohet një jetë e mirë, por Kur nuk mungojnë mjetet

Sá i bukur është dimni

Kjo është jetë! Jetë! Jetë mizore!

Atje përtej dalloj një grue . . . Më duket e rë nga mosha, Por . . . rruddhë e plakë prej vujtjesh e mundimesh. Ajo i shef mirë gëzimet e të pasunve, porse . . . Fishkllima e veriut tallët me të . . . e ka lodhë . . . nuk mundet më . . . ajo e don jetën, por . . . jeta atë e ka lanë mbas doret . . . një dashni . . . dashni e madhe fort, nuk e lënë me i dhanë fund kësaj jete . . . një dashni . . . ajo . . . është . . . nanë . . . „Nanë „ ishte të fshâmit e të birit të sajë kur pikat e shiut, ndër nett trishtimit, i pikojschin mbi lekat që i mbështjellshin trupin e njomë . . . „Nanë „ ishte vaji i foshnjës që thithte gjinin e s'amës . . . thithte . . . thithte . . . por, me kot . . . edhe qumështi kishte më . . . „Nanë „ thonte ferish-tja kur acarrija gadi ia merrte frymën . . . „Nanë „ . . . „Nanë „ . . . „Nanë „ . . .

E shkreta nanë . . . vetun vdekja do t'a lumnonte . . . vdekja do t'a lironte një herë e mirë prej ktyne krahutave jetsore . . . por . . . dashnija . . . dashnija amnore . . . kjo shkëndi i ishte i vetmi ngushllim . . . e vetmja shpresë . . .

Dimni i kandshëm: të buzqeshë, të gëzon, të defren . . . shperthen gazi e hareja nën horizontin freskues . . . Në shtëpit e të pasunve tregohen përrallat plot andje . . . por . . . nanën . . . nanën me shpresën e dashunis së vet? . . .

Oh! të pasun! . . . Kini mëshirë për skamnorët, ndajuni edhe atyne një pjesë të gëzimit t'uej . . . „Nanën „ at krijesë fatmjere . . . ate . . . mos e harroni . . .

11-Fruer-'36

Lazër Radi

Një vrapim në malin e Krabës.

Që me vesën e mëngjesit çdo konkurent i armatosur me çdo q'i lypsej, po i drejtohej oborrit të shkollës, vëndit të cakë-tuar për t'u-mbledhur; cakëza me bukën e lidhur ndaj rrypit dhe këpucët e rrobat e holla e sa më të lehta i jipnin typin e një ushtarit të thjeshtë.

Në këto e sipër dhe dielli dritëdhënës po i lëshonte dhe një herë rrezet e 'tija kundrejt fletëve të vesuara të portokaleve duke i bërë këto të shkëlqejnë si mos kurrë: Mëgjeset e ëmbë-la e të bukura të Majit të vinin me një herë ndërmënd, me gjithë që, nga çdo krah që të ktheheshe, shkretëtirat e Dimërit

mbretëronin.

Eshtë ora tetë e mëngjesit. Në pak kohë të gjithë konkurentat shkollorë e jashtëshkollorë të qytetit ishin mbledhur aty dhe Z. Z, Profesorët, pasi na dhanë numurat, na vunë në rreshtë dhe shkuam në këmbën e urës së Zaranikës, në vëndin e nisjes së vrapimit.

Kaloj diku një orë e ca ndërkaqë dhe dielli i kishte shtrirë gjer' e gjerë shigjetat e 'tij mbi tërë qytetin

Ora po qëllon plot dhjetë Bobo! sa fort qëllon tik-taku! . . . Por i kujt vallë? — i zemrës: janë çastet e nisjes. Shtëpij' e bardhë në majën e malit sapo shquan. Atje na presin! Kush do të sosij vallë i pa. " Marsh "

Maqina kinematografike zuri të punojë me të shpejtë përpara neve: herë na paraqiten fusha të mbjella, na paraqitet ullishta, kasolle bujqësh, më tej lumi Kusha, asëlle, gërxhe me shkëmbenjë e ferra, dhe së fundi ja dhe kull' e bardhë mbi sheshin e malit.

Passi dorëzova numurin, u-çlodha pakëz e pastaj i u-drejtova cepit të sheshit, me qëllim që s'andejmi të shfërenja më mirë duke vështruar vëndet e largëta dhe pamjet e ndryshme të 'tyre. Përnjëherësh e harrova fare lodhjen e kaluar, nga shkakku se një figur' e pasur e romantike u-çfaq para mejet. Kushdo t'jetër t'ishte në vëndin t'im, në mes të gjithë kësaj hapësire, kështu do t'a pësonte.

Tej fare deti sapo që shquhej ndëpërmjet një reje të sbardhëlluar. Hedh pastaj sytë nga J. dhe më çfaqet Tomori, gjigand' i tërë! Mbi çdo vënd t'jetër ky duket. Pamje të çuditëshme mer nga dbora, e cila si kurorë i qëndron prej mesit e lart. Mbeta më si i ngrirë në vënd duke ulur dal nga dal sytë nga an' e L., por prapë t'jetër figurë magjike vret syt' e mija... Elbasani i rrethuar nga nj'anë prej Shkumbinit e nga anët e tjera me kodrat e ullishtave.

Me mijëra herë atëhere shpirti' i im mallëkon atë, që për herë të parë goditi shtëpi nëpër fusha e jo nëpër të këtilla maja, nga të cilat të mundij çdo herë zemra e njeriut të shkretë të shkojë pak orë të gëzuar e dëfrenjëse duke shijuar pamjet madhështore të natyrës. Janë me të vërtetë çaste në të cilat njeriu i shkretë kaqë entuziazmohet, saqë do të donte t'a shkonte gjithënjë jetën e 'tija nëpër vënde të 'tilla të lara nga dielli, vë-

nde në të cilët zogjt e vegjël ngrehin pa frikë folet' e 'tyre.

Po të hedhësh sytë dhe më të poshtë qytetit, së shpejti do t'arrish dhe në fushën Mbret, në të cilën shtëpit' e ulëta e të bardha fare të duken si një kope dhënësh të përhapura në një asëll të gjelbër. Vetëm mos u-gënjefsh të vazhdosh kështu duke vështruar gjat drejtimin të lumit, se Shkumbini, nga një vënd në t'jetrin e nga një arë në t'jetrën, do të të futij në thekra të gjata e sidomos nashti në Dimër.

Së këtejmi të gjithë vëndet e tjerë të shtruar, të bukur e të hijshëm duken, por dhe bukuritë që mundin të shijojnë këto maja, mbi të cilat gjëndemi në këto çaste, asnjë nga të parët s'mundi t'i gëzojë. Oh, ti çoban që ron mbi male je me të vërtet i zilepsur edhe aqë sa njeri s'e mendon dot. Mburu pra për këtë gjë. Kasollja e jote e vogël e e varfër, për të cilën të janë të tepërta shpenzimet e mëdha e veglat lluksoze, të kënaq. Në 'të e kalon jetën t'ende të lumtur duke shijuar natyrën, e cila gjithënjë qëndron e gjerë e pasur rreth e rrotull teje. Je lark nga jeta e ngatëruar e zhurmonjëse e qytetit; aty e ke fare afër Krijonjësin e Gjithësisë dhe po të duash fjalosej me 'Të. Në verë për shtresë ke barin e fletët e buta dhe për mbulesë yjt' e Hënën. Të mirat e dheut të rrethojnë; s'ka më të mirë pallat se ay i yti e je mbret pa dashur.



Hëngrëm bukë e qëndruam gjer sa dielli zu' të varej përsëri e bashkë me të po vareshim më të poshtë dhe ne. Gjat rrugës i a çkulëm njëdy herë vënçe, lapçe fare, dhe sa bukur vente! Dukej se i përshtatej dhe vëndi këngës s'onë dëgjohej më mirë se çdo herë.

Duke qeshur e duke kënduar arritëm gjer në qytet e në pak kohë u-shpërndamë të gjithë nëpër shtëpitë t'ona

Në darkë pastaj, ose më mirë të them pas tërmetit, i cili na u-bë si i zakonshëm këtë copë herë, desha dhe unë të hapnja një libër e të këndoja, por, pa e kupëtuar fare, kjo m'u-mbyll Gjumi më kish zënë mu nd'anë të zjarrit E gjeta pra rastin t'i shikoj edhe një herë të gjalla pamjet e ndryshme të ditës ëndëra plot!

Vjerrsha për shkollat fillore.

Nga një liberth' i
pabotuem:

“Xixillojat e vogla,”

Votra.

Moj e dashtun votër,
Ku gjëj çdo gëzim,
Me prind, vlla e motër
Ti na fal bashkim.

Votra e shtëpis
Asht vend' i gëzimit,
Burim' i dashnis
Edhe i bashkimit.

Rreth teje vargohemi,
Qeshim, kuvëndojmë,
Kur prânë zjarrit ngrohemi
E prrailaz tregojmë.

Lum kush ka shijuem
Jetën nëpër votra,
Kur është perralluem
Me vllazën e motra

Ndokush nga mërgimi
Shpejt ka me nxitue
E një ditë gëzimi
Prânë votrës me shkue...

Qukapiku

(S. N. F.)

Shoqënia Naim Frashëri

Qëllimi kryesor
I s'onës snoqni
Asht për një puntor
Që s' u-loth për Shqipni.

Po kasapi i gjithësis.
Se la të këthente n'Arbëni,
Po e mbuloi ndën dhë t' Asis
Tuj i pre fjalën: Rrofs! Shqipni.

Dirgësh, shkruente, pa pushuë Na, si të ri Shqiptarë
Për këtë Shqipni, që na sot kemi, Do t'përpiqemi pa pushuë,
Ta shifte këte të liruë Ndën udhëheqjen e **Zogut Parë**
Ndën një mbret Shqiptar si jemi. Eshtnat e 'tij për me i prue.

Edhe toka vetë do të flasë
Kur në gjë të 'sajë ate do të ketë
Do të mburret e do të bërtasë
Fli! pusho! tashti i qetë.

G. Kuqi '39.

Një Anekdotë

Mbreti i Gjermanis, Federiku i II, kishte zakon që çdo mëgjes i radhiste ushtarët e tij një-nga një dhe u bante këto tri pyetje me radhë: 1- Sa vjeç je, 2- Sa vjet ke në shërbimin e kësaj ushtrie dhe 3- A je i kënaqun nga oficerat dhe nga ushqimi.

Një herë erdhi në kët ushtri një ushtar francez, i cili nuk e dinte aspak Gjermanishten, kështu që u-shtërngua me mësue vetëm tri fjalë sa për t'u përgjegjun Mbretit në pyetjet, që do t'i bante.

Në pyetjen e parë të përgjigjesh " 25 „, në të dytën " një „ dhe në të tretën " të dy „.

" Njëzet e pesa „ do t'i përgjigjesh moshës së tij, "një-shi„ kohës që kishte hymë në këte shërbim ushtarak dhe e treta, se ishte i kënaqun si nga oficerat, ashtu dhe nga ushqimi.

Të nesërmen, Federiku i II, simbas zakonit, erdhi tek ushtarët e tij dhe filloi pyetjet. Kur erdhi radha tek ushtari frances Federiku e pa të ri dhe nuk e pyeti herën e parë sa vjeç je, por i tha i habitun: "sa vjet ke në shërbimin e kësaj ushtrie?„ Francezi, që nuk kuptonte ç'i tha Mbreti, u përgjegj si mbas radhës, që e kishin mësue shokët, tue i thanë " 25 „; herën e dytë Mbreti e pyeti "sa vjeç je?„ edhe ai u përgjegj "një„. Federiku mbeti i habitun nga këto përgjigje trashanike dhe pastaj tue u nxemë pak i tha: "Kush asht budalla ti që flet kështu apo unë, që s kuptoj„ Edhe ushtari iu përgjegj "të dy„.

Të gjithë filluan me qeshë por mbretit të habitun ia spjeguen, tue i thanë se ishte një frances edhe se s'dinte Gjermanishten.

E përktheu : Eleonora Floqi '39.

Lajmet e shkollës

Erdhën nga Gjeneva tre mësues, normalistë e stazhistë, Hasan Rami, Xhevdet Kofina e Musa Muhja, që i dërgoi vjet Ministrija për studime pedagogjike jashtë. Këta preferuen të venë në Institutin e famshëm të Gjenevës të I. I. Rousseau-it, ku mësojnë profesorë me famë botnore, si Claparède i, Piaget-i, Bovet i e të tjerë. Po mbassi me rrogën që u jipte Ministrija, 150 fr. ari, nuk mund të rrojshin në at vend të shtrëjtë, sikurse është Svicra, u-shtërnguen të kthehen e t'i lanë studimet, tue u-emnue prapë në vendet e mëparshme. Ata na treguen shumë fjalë të mira për at Institut me emën dhe kishin tërheqë simpathin 'e vretjen e profesorëve për sjelljen e bukur të tyre. Profesor Piaget-it i kishte tërheqë vretjen shumë përshëndetja e jonë komtare me dorë në krahnuer e ua kthente dhe ai at përshëndetje, sa herë që piqesh me ta. Profesori plak Claparède-i i kish thirrë për drekë ditën e vitit të ri bashkë me studentët të tjerë dhe ishte ngashërye tepër, kur u-da prej tyre. Tash në at Institut studjon me të hollat e veta normalisti mësues Sotiraq Paparistoja; Reuf Nuredini, normalist, studjon pedagogji me bursë të Ministrisë në Lion të Francës. Urojmë që edhe të tjerë normalistë të venë të studiojnë në Evropë pedagogji, për të mirën e shkollës shqiptare.

Z. Kol Popa u emëruë profesor i shkencave natyrore në shkollën t'onë. "Normalisti," i uron sukses.

Pardje të Djelën më 23 të Muajit u-shvilluan dy ndeshje midis shkollës s'onë dhe Institutit Teknik në Tiranë: një ndeshje foot-ball-i dhe një voley-ball-i. Si në të parin ashtu dhe në të dytën doli fitues Instituti Teknik.

Mësuesi Vini Re ! Mjerisht "Normalisti," qarkullon më tepër nëpër qendra. Na nuk kënaqemi me kaq Duam qi organi' i ynë të shkojë edhe në katundin më të vogël ku ndodhet shkoll' e hapur. Atëhere përmbushet qëllimi' i ynë. Prandaj, që të përhapet sa më tepër e përkohshmja, lajmëroni kolegët t'uaj ndër krahinat ta pajtohen sa më parë.

Posta e jonë:

E ndjejmë për detyrë të falenderojmë të gjithë përfaqësuesit t'anë q'u munduan aq shumë për të përhapur të përkohëshmen. Veçanërisht jemi mirënjohës kundrejt Z. Muharem Musa, përfaqësuesi i ynë në Kukës, i cili, me gjithë vështirësit nga mungesat e komunikacionit në krahinën e tij, mundi të na sigurojë të gjithë pajtimet e qarkut duke u bërë shembëll për të tjerët.

- G. Santo Kolonjë. Do të botohet. Të fala
- L. Radi Shkodër. Presim ç' ka na premtoni.
- T. Gjyshja Shkodër. Presim prej Jush. Të fala.
- B. Zotto Gjirokastër. Për revistën mirruni vesh me Z. Neshet Jupi. Do të botohet.
- S. Alliu. Trebisht. Do të botohet. Falnderojmë për fjalët e mira. Të fala.
- I. Lesko Gjirokastër. Do të botohet. Të fala.

— Z. Z. V. Nasto, Zef Pali, Petër Elezi, Beqir Spahiu, Isuf Çeka, Dhosi Lipi, Pano Vasili, Shasivar Islami, Ymer Berisha, Niko Gjini, Alfred Andoni, Vasil Kushi, Rahmi Hoxha, Qamil Shehu, Zenel Sopot, Fahri Ismail.

Në numërin e parë nuk ju thirëm për bashkëpunim se nuk ju njihnim. Na falni për këtë.

Presim shkrime prej jush.

V. R. Premtimin e parë e mbajtëm: i shtuam 4 faqe të tjera. Por dëshira e jonë e përherëshme është: **Mir' e më mirë** prandaj prisni numërin tjetër me një bashkëpunim më të gjërë.

↑
17 Prova Praktike

17 Prova Praktike